



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government Zyra e Kryeministrit - Kancelarija Premijera - Office of the Prime Minister

Zyra e Kryeministrit - Kancelarija Premijera - Office of the Prime Minister

RREGULLORE (ZKM) NR. 04/2026 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË PËR ZHVILLIMIN E RINISË¹

¹ Rregullorja ZKM-Nr. 04/2026 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë për Zhvillimin e Rinisë është miratuar nga Kryeministri në detyrë me Vendimin Nr. 344/2026, të datës 26.01.2026.

Kryeministri i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 94 (paragrafi 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazur në nenin 9 (paragrafi 1.3) i Ligjit Nr. 08L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10 (paragrafi 4) të Ligjit Nr. 08/L-264 për Rininë, nenit 28 (paragrafi 3) të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, si dhe nenin 9 (paragrafi 7) të Rregullores Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura,

Nxjerr:

RREGULLORE (ZKM) NR. 04/2026 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË PËR ZHVILLIMIN E RINISË

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë për Zhvillimin e Rinisë (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia).

Neni 2 Fushëveprimi

1. Kjo rregullore zbatohet nga Agjencia.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë janë të përcaktuara në Ligjin përkatës për Rininë.

KAPITULLI II ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMI I VENDEVE TË PUNËS

Neni 3 Misioni i Agjencisë

Misioni i Agjencisë është zbatimi i legjislacionit përkatës për Rininë, Strategjisë Shtetërore për Rininë, programeve për mbështetjen e rinisë të financuara nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga donatorët shtetërorë dhe ndërkombëtarë, si dhe mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave dhe informatave në fushën e rinisë, në bashkëpunim me institucionet publike qendrore

dhe lokale.

Neni 4 **Struktura organizative e Agjencisë**

1. Struktura organizative e Agjencisë është si në vijim:

1.1. Zyra e Drejtorit/eshës Ekzekutiv/e;

1.2. Departamentet;

1.3. Divizionet.

2. Numri i të punësuarve në Agjenci është njëzet e tre (23).

3. Shërbimet e përgjithshme të administratës, shërbimi i prokurimit, menaxhimit financiar, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe auditimit të brendshëm kryhen nga njësitë përgjegjëse administrative të Ministrisë përkatëse për Rininë.

Neni 5 **Zyra e Drejtorit/eshës Ekzekutiv/e**

1. Zyra e Drejtorit/eshës Ekzekutiv/e përbëhet nga:

1.1. Drejtori/esha ekzekutiv/e;

1.2. Zyrtar për administrim dhe digjitalizim;

1.3. Zyrtari/ja administrativ/e.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit/eshës Ekzekutiv/e përcaktohen me Ligjin përkatës për Rininë, Ligjin përkatës për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Ligjin përkatës për Zyrtarët Publikë, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit administrativ të Zyrës së Drejtorit/eshës Ekzekutiv/e përcaktohen me legjislacionin përkatës për zyrtarët publikë.

4. Numri i të punësuarve në Zyrën e Drejtorit/eshës Ekzekutiv/e është tre (3).

Neni 6 **Departamentet dhe divizionet e Agjencisë**

1. Departamentet dhe divizionet e Agjencisë janë:

1.1. Departamenti për Koordinimin e Politikave dhe Mbështetje të Rinisë:

1.1.1. Divizioni për Koordinimin e Politikave Rinore;

1.1.2. Divizioni për Pjesëmarrje Rinore;

1.1.3. Divizioni për Mbështetje të Rinisë.

1.2. Departamenti për Zbatim të Shërbimeve dhe Programeve Rinore:

1.2.1. Divizioni për Shërbime Rinore;

1.2.2. Divizioni për Programe Rinore;

1.2.3. Divizioni për Monitorim dhe Vlerësim.

Neni 7

Departamenti për Koordinimin e Politikave dhe Mbështetje të Rinisë

1. Departamenti për Koordinimin e Politikave dhe Mbështetje të Rinisë ka për mision koordinimin, bashkëpunimin dhe mbështetjen ndërinstitucionale në nivel qendror dhe lokal në fushën e rinisë, promovimin e pjesëmarrjes së të rinjve në politikbërje, si dhe mbështetjen e projekteve dhe programeve që kanë për qëllim zhvillimin e rinisë.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Koordinimin e Politikave dhe Mbështetje të Rinisë janë:

2.1. Siguron koordinimin e aktiviteteve në nivel shtetëror, ndërinstitucional dhe ndërsektorial për identifikimin e nevojave të të rinjve dhe zhvillimin e politikave dhe shërbimeve që adresojnë ato nevoja;

2.2. Vepron si sekretariat i Komisionit Shtetëror për Rini (KShR) për koordinimin e ministrive dhe institucioneve të tjera publike në përcaktimin e prioriteteve dhe masave në fushën e rinisë;

2.3. Vepron si urë lidhëse mes të rinjve, fushës së rinisë dhe institucioneve publike qendrore dhe lokale;

2.4. Krijon dhe mbështet grupe këshilldhënëse me përbërje profesionale, së bashku me përfaqësuesit e të rinjve, për të siguruar që politikat janë në përputhje me nevojat e të rinjve;

2.5. Udhëheq zhvillimin dhe zbatimin e programeve prioritare shtetërore ndërministrorë në bashkëpunim me departamentin tjetër të Agjencisë;

2.6. Mbështet zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Shtetërore për Rininë dhe Planet e Veprimit;

2.7. Bën koordinimin e të dhënave me qëllim zhvillimin e raporteve për Ministrinë përkatëse të Rinisë, donatorët dhe organizatat ndërkombëtare;

2.8. Mbështet institucionet publike lokale në zhvillimin dhe zbatimin e politikave lokale në fushën e rinisë;

- 2.9. Mbështet themelimin dhe funksionimin e mekanizmave përfaqësues rinorë, në veçanti të Këshillit Qendror Rinor;
- 2.10. Organizon ngjarje vjetore me qëllim promovimin e pjesëmarrjes rinore në politikbërje dhe ndërlihdjen e institucioneve publike qendrore dhe lokale me sektorin e rinisë;
- 2.11. Shpall thirrje publike vjetore për mbështetjen financiare të programeve dhe projekteve të fushës së rinisë, me qëllim zhvillimin e të rinjve, duke u bazuar në prioritetet e përcaktuara nga KShR-ja dhe Strategjia Shtetërore për Rininë;
- 2.12. Ofron informata dhe programe për ngritjen e kapaciteteve të organizatave dhe grupeve që përbëjnë sektorin e rinisë për sigurimin e mbështetjes financiare dhe zbatimin e programeve dhe projekteve në dobi të të rinjve.
3. Drejtori/esha i/e Departamentit për Koordinimin e Politikave dhe Mbështetje të Rinisë raporton te drejtori/esha ekzekutiv/e i Agjencisë.
4. Departamenti për Koordinimin e Politikave dhe Mbështetje të Rinisë përbëhet nga tri divizione:
- 4.1. Divizioni për Koordinimin e Politikave Rinore;
- 4.2. Divizioni për Pjesëmarrje Rinore;
- 4.3. Divizioni për Mbështetje dhe Zhvillim të Rinisë.
5. Numri i të punësuarve në Departamentin për Koordinim dhe Mbështetje është dhjetë (10).

Neni 8

Divizioni për Koordinimin e Politikave Rinore

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Koordinimin e Politikave Rinore janë:
- 1.1. Koordinon komunikimin ndërinstytucional në fushën e rinisë sa herë që identifikohet nevoja ose kërkohet nga një institucion, përfaqësues i shoqërisë civile, media apo një hisedar i sektorit të rinisë;
- 1.2. Orienton hisedarët e sektorit të rinisë, përfshirë të rinjtë si individë, për mundësitë, shërbimet dhe të drejtat që ofrohen në Republikën e Kosovës për rininë nga Agjencia, ministrinë, donatorët dhe institucionet e tjera publike qendrore dhe lokale;
- 1.3. Ofron këshilla për shfrytëzimin e mundësive, shërbimeve dhe të drejtat e të rinjve të garantuara me legjislacionin në fuqi, përfshirë ato që zbatohen nga institucionet e tjera qendrore dhe lokale ose donatorët;
- 1.4. Bashkëpunon dhe mbështet KShR-në në përcaktimin e prioriteteve dhe masave të nevojshme që duhet të ndërmerren për adresimin e nevojave të të rinjve;
- 1.5. Ofron mbështetje në koordinimin, monitorimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të

nevojshme për punën e KShR-së, duke vepruar si sekretariat;

1.6. Harton raporte lidhur me zhvillimet në fushën e rinisë për KShR-në, Ministrinë përkatëse të Rinisë, donatorët dhe organizatat ndërkombëtare;

1.7. Dërgon të dhëna dhe propozon politika lidhur me kërkesat dhe nevojat e të rinjve të KShR-ja, institucionet publike qendrore dhe lokale;

1.8. Merr pjesë dhe kontribuon në hartimin e dokumenteve strategjike, politikave sektoriale rinore, akteve ligjore dhe akteve nënligjore sektoriale në nivel qendror që kanë për qëllim zhvillimin e rinisë;

1.9. Mbështet institucionet publike lokale në hartimin dhe zbatimin e politikave lokale në fushën e rinisë dhe planin vjetor për rininë në përputhje me Strategjinë Shtetërore për Rininë;

1.10. Koordinon donatorët dhe organizatat ndërkombëtare dhe ofron informata sipas nevojës dhe kërkesave.

2. Udhëheqësi/ja i/e Divizionit për Koordinimin e Politikave Rinore raporton te drejtori/esha i/e Departamentit për Koordinimin e Politikave dhe Mbështetje të Rinisë.

3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Koordinimin e Politikave Rinore është tre (3).

Neni 9 **Divizioni për Pjesëmarrje Rinore**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Pjesëmarrje Rinore janë:

1.1. Ofron mbështetje për themelimin dhe funksionimin e Këshillit Qendror Rinor;

1.2. Evidenton funksionimin dhe mosfunksionimin e Këshillit Qendror dhe ndërmer masat e nevojshme për shpërbërje;

1.3. Ofron mentorim për Këshillin Qendror Rinor për zbatimin e aktiviteteve dhe çështjeve të tjera administrative;

1.4. Si Sekretariat i Këshillit Qendror Rinor, e mbështet atë në aspektin financiar duke përfshirë kostot e aktiviteteve vjetore të Këshillit nga buxheti vjetor i Agjencisë;

1.5. Shqyrton dhe aprovon/refuzon të gjitha kërkesat financiare nga Këshilli Qendror Rinor me kohë, përfshirë:

1.5.1. Kostot e organizimit të takimit të Asamblesë së Këshillit Qendror;

1.5.2. Takimet periodike të Këshillit Qendror;

1.5.3. Shpenzimet e udhëtimit në takimin e Asamblesë dhe në takimet e Këshillit Qendror;

- 1.5.4. Shpenzimet për mëditje sipas rregullores së qeverisë në raste të udhëtimit jashtë vendit;
- 1.5.5. Shpenzimet për shërbimet administrative të takimeve të tjera të parapara në planin e aktiviteteve të Këshillit Qendror.
- 1.6. Shqyrton raportin vjetor narrativ dhe financiar të zbatimit të aktiviteteve të Këshillit Qendror Rinor;
- 1.7. Bashkëvepron me Këshillin Qendror Rinor për identifikimin e nevojave të rinisë, duke organizuar takime periodike me Këshillin Qendror;
- 1.8. Mbështet pjesëmarrjen e Këshillit Qendror Rinor në takime me interes për rininë në institucionet qendrore të Republikës së Kosovës dhe jashtë vendit;
- 1.9. Mbështet funksionimin e Këshillave Lokalë Rinorë sipas kërkesës së komunave përkatëse;
- 1.10. Mbështet të rinjtë duke ndarë informatat për proceset e ndryshme të politikbërjes ndërinstitucionale në fusha me interes për të rinjtë;
- 1.11. Mbështet institucionet publike qendrore dhe lokale në përfshirjen e të rinjve në proceset e politikbërjes;
- 1.12. Ofron mbështetje për komunat sipas nevojës për licencimin e të paktën një qendre rinore;
- 1.13. Inicion dhe koordinon organizimin e aktiviteteve ndërinstitucionale për pjesëmarrjen e rinisë, duke përfshirë Muajin e Rinisë, Konferencën Vjetore dhe Dialogun Kombëtar për Rininë.
2. Udhëheqësi/ja i/e Divizionit për Pjesëmarrje Rinore raporton te drejtori/esha i/e Departamentit për Koordinimin e Politikave dhe Mbështetje të Rinisë.
3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Pjesëmarrje Rinore është tre (3).

Neni 10

Divizioni për Mbështetje të Rinisë

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Mbështetje të Rinisë janë:
- 1.1. Dizajnon objektivat specifike dhe kriteret e veçanta të projekteve dhe programeve për mbështetjen financiare të organizatave rinore, organizatave për të rinjtë, individëve rinorë dhe grupeve joformale, duke u bazuar në Strategjinë Shtetërore për Rininë;
- 1.2. Përgatit dhe publikon kalendarin e thirrjeve publike të Agjencisë dhe, sipas mundësisë, të institucioneve të tjera publike qendrore dhe ndërkombëtare, për hisedarët e sektorit të rinisë;

- 1.3. Ofron mbështetje financiare përmes granteve institucionale për Qendrat Rinore për zbatimin e programeve vjetore;
 - 1.4. Administron thirrjet për mbështetje financiare të fushës së rinisë, përfshirë edhe thirrjet publike për anëtarë të jashtëm në komisionin e vlerësimit;
 - 1.5. Mbledh aplikimet për mbështetje financiare të fushës së rinisë;
 - 1.6. Siguron vlerësimin përmbajtësor të aplikimeve për mbështetje financiare në mënyrë transparente, të drejtë dhe brenda afateve;
 - 1.7. Përgatit dhe ndan me Ministrinë përkatëse të Rinisë listën preliminare të përfituesve;
 - 1.8. menaxhon procedurat e ankesave sipas legjislacionit në fuqi;
 - 1.9. Përgatit dhe ndan me Ministrinë përkatëse të Rinisë listën përfundimtare të përfituesve;
 - 1.10. Përgatit kontratat dhe dokumentacionin tjetër përkatës për përfituesit e mbështetjes financiare;
 - 1.11. Pranon raportet dhe përgatit mbylljen e kontratave me përfituesit e mbështetjes financiare;
 - 1.12. Promovon mundësitë për mbështetje financiare për organizatat dhe ofron udhëzime dhe ndihmë për aplikuesit gjatë procesit të aplikimit, duke ofruar së paku një sesion informues për çdo thirrje;
 - 1.13. Ofron ngritje të kapaciteteve për organizatat rinore, organizatat për të rinjtë dhe grupet joformale rinore në bashkëpunim me organizata të tjera;
 - 1.14. Mbështet organizatat që ofrojnë ngritje të kapaciteteve në fushën e rinisë;
 - 1.15. Bashkëpunon me divizionet e tjera dhe organizatat e tjera për të vënë në përputhje programet e granteve me politikat rinore dhe nevojat e rinisë.
2. Udhëheqësi/ja i/e Divizionit për Mbështetje të Rinisë raporton te drejtori/esha i/e Departamentit për Koordinimin e Politikave dhe Mbështetje të Rinisë.
 3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Mbështetje të Rinisë është tre (3).

Neni 11

Departamenti për Zbatim të Shërbimeve dhe Programeve Rinore

1. Departamenti për Zbatim të Shërbimeve dhe Programeve Rinore ka për mision promovimin dhe monitorimin e standardeve të punës rinore, edukimit joformal dhe vullnetarizmit rinor, si dhe promovimin e mobilitetit rinor, monitorimin e progresit dhe vlerësimin e ndikimit të programeve rinore, duke përfshirë menaxhimin e të dhënave në fushën e rinisë.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Zbatim të Shërbimeve dhe Programeve Rinore janë:

2.1. Bën monitorimin e progresit dhe vlerësimin e ndikimit të shërbimeve, programeve dhe projekteve rinore të zbatuara dhe të mbështetura nga Agjencia, duke përfshirë në proces partnerë të jashtëm dhe të pavarur;

2.2. Zhvillon punën rinore sipas zhvillimeve, praktikave dhe rekomandimeve të fundit të politikës rinore evropiane;

2.3. Monitoron standardet, kapacitetet dhe impaktin e punëtorëve rinorë;

2.4. Ofron programe për ngritjen e kapaciteteve të punëtorëve rinorë, përfshirë programe studimore brenda dhe jashtë vendit;

2.5. Bën licencimin e punëtorëve rinorë, revokimin dhe ripërtërirjen e licencave;

2.6. Monitoron dhe zhvillon standardet e programeve të edukimit joformal;

2.7. Promovon vullnetarizmin rinor dhe mbron të drejtat e vullnetarëve të rinj;

2.8. Certifikon orët e punës vullnetare;

2.9. Promovon mobilitetin rinor përmes Kartës Rinore Evropiane dhe programeve të tjera në nivel rajonal, evropian dhe më gjerë;

2.10. Mbështet anëtarësimin dhe përfaqësimin e institucioneve, organizatave dhe të rinjve në shoqata, organizata dhe rrjete ndërkombëtare në fushën e rinisë;

2.11. Bën monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e shërbimeve, programeve dhe projekteve të mbështetura nga Agjencia;

2.12 Mbledh, përpunon, menaxhon dhe ofron të dhëna në fushën e rinisë.

3. Drejtori/ësha i/e Departamentit për Zbatim të Shërbimeve dhe Programeve Rinoreraporton te drejtori/ësha ekzekutiv/e i/e Agjencisë.

4. Departamenti për Shërbime Rinore dhe Zbatim të Programeve përbëhet nga tri divizione:

4.1. Divizioni për Shërbime Rinore;

4.2. Divizioni për Programe Rinore;

4.3. Divizioni për Monitorim dhe Vlerësim.

5. Numri i të punësuarve Departamentin për Zbatim të Shërbimeve dhe Programeve Rinore është dhjetë (10).

Neni 12

Divizioni për Shërbime Rinore

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Shërbime Rinore janë:

- 1.1. Licencon punëtorët rinorë të kualifikuar;
- 1.2. Inicion dhe menaxhon bashkëpunimin me organizatat dhe institucionet arsimore brenda dhe jashtë vendit për ofrimin e aftësisë profesionale për punëtorët rinorë;
- 1.3. Përcakton dhe monitoron standardet e zhvillimit të punës rinore dhe edukimit joformal;
- 1.4. Ndërmerr masa në raste kur punëtori rinor shkel dispozitat ligjore për punën rinore;
- 1.5. Mbështet komunikimin dhe koordinimin e punëtorëve rinorë të licencuar me organizatat rinore, organizatat për të rinjtë dhe grupet rinore joformale;
- 1.6. Promovon rëndësinë e edukimit joformal dhe mbështet fuqizimin e të rinjve përmes edukimit joformal;
- 1.7. Mbështet organizatat për akreditim në fushën e edukimit joformal në bashkëpunim me institucionet përkatëse në kuadër të Ministrisë përkatëse të Arsimit;
- 1.8. Mbështet dhe fuqizon vullnetarizmin rinor dhe ofron stimuj për vullnetarët rinorë;
- 1.9. Krijon përmbajtje të re dhe siguron pasurimin e platformës elektronike të vullnetarizmit në bashkëpunim me specialistin e digjitalizimit;
- 1.10. Organizon takime periodike vetëdijesuese me vullnetarët rinorë dhe ofruesit e punës vullnetare mbi të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre;
- 1.11. Mbështet institucionet publike qendrore dhe lokale në angazhimin e vullnetarëve rinorë dhe ofrimin e stimujve për vullnetarizmin rinor;
- 1.12. Përzgjedh dhe ndan çmime për vullnetarët e vitit në baza vjetore.

2. Udhëheqësi/ja i/e Divizionit për Shërbime Rinore raporton te drejtori/eshja i/e Departamentit për Zbatim të Shërbimeve dhe Programeve Rinore.

3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Shërbime Rinore është tre (3).

Neni 13

Divizioni për Programe Rinore

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Programe Rinore janë:

- 1.1. Zhvillon dhe zbaton programe shtetërore në fushën e rinisë, të cilat parashihen nga Strategjia Shtetërore për Rininë dhe nuk përkojnë me divizionet e tjera të Agjencisë;

- 1.2. Zbaton programet e Shoqatës së Kartës Rinore Evropiane në vend;
 - 1.3. Bashkëpunon me organizata të shoqërisë civile dhe palë të tjera për zbatimin e aktiviteteve të Kartës Rinore Evropiane për pajisjen e të rinjve me kartën dhe negociimin e përfitimeve nga ajo kartë;
 - 1.4. Vepron si pikë kontakti (help desk) për publikun mbi Kartën Rinore Evropiane;
 - 1.5. Krijon përmbajtje të re dhe siguron pasurimin e platformës rinia.rks-gov.net si pikë digjitale ku të rinjtë dhe organizatat njoftohen mbi mundësitë e reja;
 - 1.6. Zbaton komponentën e shtrirjes në kuadër të Skemës së Garancisë Rinore dhe mbështet institucionet publike qendrore dhe lokale në vlerësimin e nevojave dhe zbatimin e planit të veprimit të Skemës së Garancisë Rinore;
 - 1.7. Bashkëpunon me organizatat vendore dhe ndërkombëtare në zgjerimin e mundësive për mobilitetin rinor brenda dhe jashtë vendit;
 - 1.8. Bashkëpunon me Divizionin për Mbështetje në hartimin dhe administrimin e thirrjeve për mobilitet rinor brenda dhe jashtë vendit;
 - 1.9. Mbështet të rinjtë dhe organizatat në aplikimin dhe pjesëmarrjen në programet e shkëmbimit kulturor, sportiv, edukativ, vullnetar dhe të punës në shtete evropiane dhe më gjerë, duke përfshirë por duke mos u limituar në:
 - 1.9.1. Zyrën Rajonale për Bashkëpunim Rinor;
 - 1.9.2. Erasmus+;
 - 1.9.3. Shoqatën e Kartës Rinore Evropiane;
 - 1.9.4. Korpusin Evropian të Solidaritetit;
 - 1.9.5. SALTO-Youth.
 - 1.10. Mbështet anëtarësimin dhe përfaqësimin e institucioneve, organizatave dhe të rinjve në shoqata, organizata dhe rrjete ndërkombëtare në fushën e rinisë;
 - 1.11. Mbështet teknikisht dhe financiarisht organizimin e ngjarjeve rajonale, evropiane dhe më gjerë në fushën e rinisë, në bashkëpunimin me Divizionin për Mbështetje të Rinisë.
2. Udhëheqësi/ja i/e Divizionit për Programe Rinore raporton te drejtori/eshja i/e Departamentit për Zbatim të Shërbimeve dhe Programeve Rinore.
 3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Programe Rinore është tre (3).

Neni 14

Divizioni për Monitorim dhe Vlerësim

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Monitorim dhe Vlerësim janë:

1.1. Zhvillon mjetet e punës për monitorimin dhe vlerësimin e mbështetjes financiare në linjë me objektivat e Strategjisë Shtetërore për Rininë, duke përfshirë:

1.1.1. Definimin e standardeve të protokollit për monitorim nga monitoruesit e Agjencisë dhe për raportim nga përfituesit e mbështetjes financiare;

1.1.2. Planifikimin paraprak dhe zhvillimin e planit vjetor të monitorimit, bazuar në projektet e miratuara për mbështetje financiare;

1.1.3. Rishikimin dhe zhvillimin e formateve të raporteve të monitoruesve dhe përfituesve.

1.2. Menaxhon kontratat e mbështetjes financiare për organizatat rinore, organizatat për të rinjtë, grupet joformale rinore dhe grantet institucionale për qendrat rinore;

1.3. Bën monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të projekteve dhe programeve nga organizatat rinore, organizatat për të rinjtë dhe grupet joformale rinore, duke zhvilluar një sistem për regjistrimin, monitorimin dhe raportimin e përfituesve të thirrjeve publike;

1.4. Ofron rekomandime për Divizionin për Mbështetje të Rinisë në lidhje me ngritjen e kapaciteteve të organizatave rinore, organizatave për të rinjtë dhe grupeve joformale, në bazë të nevojave të identifikuara gjatë monitorimit;

1.5. Mbledh të dhëna në fushën e rinisë në bashkëpunim me institucionet publike qendrore dhe lokale dhe nxjerr rekomandime;

1.6. Krijon dhe menaxhon databazën e të dhënave të fushës së rinisë, e cila është e qasshme dhe publike, në koordinim me institucionet publike qendrore dhe lokale, si dhe me strukturat rinore;

1.7. Ofron të dhëna sipas kërkesës së institucioneve qendrore publike dhe lokale, si dhe të të rinjve.

2. Të dhënat e mbledhura nga Divizioni për Monitorim dhe Vlerësim përfshijnë por nuk kufizohen në:

2.1. Të dhëna mbi perspektivat e të rinjve, përfshirë sondazhe, fokus grupe apo intervista, për të kuptuar perspektivat, aspiratat dhe sfidat me të cilat përballen të rinjtë;

2.2. Të dhëna mbi efektivitetin e politikave rinore, duke vlerësuar ndikimin e politikave dhe programeve ekzistuese rinore;

2.3. Të dhëna mbi numrin dhe fushëveprimin e organizatave rinore, organizatave për të rinjtë dhe grupeve joformale rinore, si dhe të përfituesve të tyre;

- 2.4. Të dhëna mbi numrin dhe orët e vullnetarëve rinorë;
 - 2.5. Të dhëna mbi numrin dhe fushëveprimin e punëtorëve rinorë të licencuar dhe të përfituesve të tyre;
 - 2.6. Të dhëna demografike, përfshirë moshën, gjininë, përkatësinë etnike, etj., të të rinjve;
 - 2.7. Të dhëna arsimore, përfshirë shkallën e regjistrimit, frekuentimin, performancën në shkolla dhe institucione të arsimit të lartë, si dhe qasjen në burime dhe mundësitë arsimore, numrin e të rinjve që janë pjesë e programeve ndërkombëtare dhe të mobilitetit arsimor;
 - 2.8. Të dhëna mbi punësimin, përfshirë shkallën e punësimit tek të rinjtë, llojet e punëve më të preferuara nga të rinjtë, nivelet e të ardhurave dhe sfidat;
 - 2.9. Të dhëna mbi shëndetin dhe mirëqenien, përfshirë statistikat e shëndetit fizik dhe mendor, prezencën e çështjeve specifike shëndetësore që prekin të rinjtë, si dhe qasjen në shërbimet e kujdesit shëndetësor;
 - 2.10. Të dhëna sociale dhe kulturore, përfshirë pjesëmarrjen në aktivitete kulturore dhe rekreative, integrimin social dhe përfshirjen në komunitet;
 - 2.11. Të dhëna mbi aftësimin dhe edukimin joformal, duke përfshirë disponueshmërinë dhe qasjen në programe të zhvillimit të aftësive, si dhe mundësitë për trajnim dhe edukim profesional;
 - 2.12. Të dhëna mbi përfshirjen digjitale, përfshirë qasjen e të rinjve në teknologji dhe internet, si dhe shkallën e shkrim-leximit digjital;
 - 2.13. Të dhëna mbi angazhimin dhe pjesëmarrjen qytetare të të rinjve, përfshirë pjesëmarrjen në aktivitete qytetare në nivel qendror dhe lokal;
 - 2.14. Të dhëna mbi mbrojtjen dhe sigurinë, përfshirë shkallën e krimit dhe shqetësimet e sigurisë të të rinjtë.
3. Të gjitha të dhënat në databazën e Agjencisë menaxhohen në përputhje me Ligjin përkatës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
 4. Udhëheqësi/ja i/e Divizionit për Monitorim dhe Vlerësim raporton te drejtori/esha i/e Departamentit Zbatim të Shërbimeve dhe Programeve Rinore.
 5. Numri i të punësuarve në Divizionin për Monitorim dhe Vlerësim është tre (3).

KAPITULLI III

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15 Dispozitat kalimtare

1. Lëvizshmëria e personelit në pajtim me legjislacionin për zyrtarët publik brenda institucionit është e lejuar, nëse konsiderohet e nevojshme për mbarëvajtjen e punës.
2. Rritja apo zvogëlimi i numrit të personelit në pajtim me ligjin vjetor të buxhetit, nuk krijon nevojë për plotësim-ndryshimin e kësaj Rregulloreje, përpos në rastet kur krijohen dhe/apo shuhen strukturat organizative.
3. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, dispozitat e ligjit vjetor të buxhetit janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 16 Dispozitat përfundimtare

Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje është Shtojca I, e cila përmban numrin e përgjithshëm të të gjithë të punësuarve në Agjenci dhe numrin e veçantë për secilën njësi, si dhe Shtojca II, e cila përmban organogramin vizual.

Neni 17 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

26 janar 2026

SHTOJCA I: TABELA

ORGANOGRAMI I AGJENCISË PËR ZHVILLIMIN E RINISË			
POZITA/STRUKTURA	KLASA	GRUPI (I PËRGJITHSHËM OSE I VEÇANTË)	NUMRI
1. ZYRA E DREJTORIT/ESHËS EKZEKUTIV/E			
Drejtor/eshë ekzekutiv/e	Drejtues i lartë	N/A	1
Zyrtar/e administrativ/e	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
Zyrtar për administrim dhe digjitalizim	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
1.1. Departamenti për Koordinimin e Politikave dhe Mbështetje të Rinisë			
Drejtor/eshë për Koordinim e Politikave dhe Mbështetje të Rinisë	Drejtues/e i/e mesëm	N/A	1
1.1.1. Divizioni për Koordinimin e Politikave Rinore			
Udhëheqës/e i/e Divizionit për Koordinimin e Politikave Rinore	Drejtues/e i/e ulët	N/A	1
Zyrtar i lartë për politika rinore	Profesional 1	Grupi i administrimit të përgjithshëm	2
1.1.2 Divizioni për Pjesëmarrje Rinore			
Udhëheqës/e i/e Divizionit për Pjesëmarrje Rinore	Drejtues/e i/e ulët	N/A	1
Zyrtar i lartë për rini	Profesional 1	Grupi i shkencave shoqërore	2

1.1.3 Divizioni për Mbështetje të Rinisë			
Udhëheqës/e i/e Divizionit për Mbështetje të Rinisë	Drejtues/e i/e ulët	N/A	1
Zyrtar i lartë për rini	Profesional 1	Grupi i shkencave shoqërore	1
Zyrtar/e i/e lartë për ngritje të kapaciteteve	Profesional 1	Grupi i marrëdhënieve me publikun dhe informimin	1
1.2. Departamenti për Zbatim të Shërbimeve dhe Programeve Rinore			
Drejtor/eshë për Zbatim të Shërbimeve dhe Programe Rinore	Drejtues/e i/e mesëm	N/A	1
1.2.1 Divizioni për Shërbime Rinore			
Udhëheqës/e i/e Divizionit për Shërbime Rinore	Drejtues/e i/e ulët	N/A	1
Zyrtar i lartë për rini	Profesional 1	12 Grupi i shkencave shoqërore	2
1.2.2. Divizioni për Programe Rinore			
Udhëheqës/e i/e Divizionit për Programe Rinore	Drejtues/e i/e ulët	N/A	1
Zyrtar i lartë për programe dhe projekte	Profesional 1	Grupi i administrimit të përgjithshëm	2
1.2.3. Divizioni për Monitorim dhe Vlerësim			
Udhëheqës/e i/e Divizionit për	Drejtues/e i ulët	N/A	1

Monitorim dhe Vlerësim			
Zyrtar i lartë për analiza	Profesional 1	Grupi i shkencave shoqërore	1
Zyrtar i lartë për zhvillim dhe monitorim të zbatimit të projekteve	Profesional 1	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
NUMRI TOTAL I TË PUNËSUARËVE			23

SHTOJCA II: ORGANOGRAM

